



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më:04.11.2022

Sh. 01 Nr. 35616
U. Br.
Nr. i faq. 11 Data: 04/11
Br. str. Datum: 2022
KAMENICË

Bazuar në nenit 12 paragrafi 12.2, shkronja d) i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 12 paragrafi 1 të Rregullores (Nr.02/2021) për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31.10.2022 mori këtë:

V E N D I M
PËR PLOTËSIM / NDRYSHIM TË VENDIMIT BAZË SH.01.NR.31253 TË DATËS
29.09.2022

1. Plotësohen/ndryshohen pikat (2) dy, (3) tre dhe (4) katër e vendimit bazë Sh.01.Nr.31253 të datës 28.09.2022, dhe *riformulohen si në vijim:*
 - 1.1. *Pika (2) dy e vendimit plotësohet/ndryshohet dhe riformulohet si:* Lejohet ndarja e Subvencioneve për projektin e paraparë nga Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në Kamenicë si në tabelë të bashkangjitur në shumë prej **3,640.00** Euro, të paraparë me nenin 19 të Rregullores Sh.01.Nr.39305 i datës 16.12.2016 për Kushtet Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve Kamenicë.
 - 1.2. *Pika (3) tre e vendimit plotësohet / ndryshohet dhe riformulohet si:* Kodi për Subvencione është i paraparë në nenin 19 Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve Kamenicë të ndara në kuadër të nënprogramit, Drejtorisë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural 47029, nga kategoria për subvencione Fondi Burimore (10).
 - 1.3. *Pika (4) katër e vendimit plotësohet /ndryshohet dhe riformulohet si:* Pas miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës, në këtë rast subvencionet ndahen nga kodi i programit 47029.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit bazë Sh.01 Nr.31253 i datës 29.09.2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit,
- Zyrës së Kuvendit Komunal,
- MAPL
- Zyrës së Përkthimeve.
- QSHQ- arkiv.



Kryesues i Kuvendit Komunal